



# BULETIN INFORMATIV

Janar - Qershor 2009

**KOMISIONI PËR LEGJISLACION DHE GJYQËSI**



Kuvendi i Republikës  
së Kosovës



Janar - Qershor 2009





## **PËRMBAJTJA**

### **FUSHËVEPRIMTARIA E KOMISIONIT**

### **PLANI I PUNËS 2009**

### **MBLEDHJET E KOMISIONIT**

### **SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJEVE**

### **DËGJIMET PUBLIKE**

### **MONITORIMI I ZBATIMIT TË LIGJEVE**

### **STATISTIKA**

### **PËRBËRJA E KOMISIONIT**

## **Fushëveprimtaria e Komisionit**

**K**omisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi është komision funksional i Kuvendit të Kosovës, në fushën Legjislativo Juridike.

- Propozon, sponsoron, amandamenton ligje dhe akte të tjera të Kuvendit;
- Shqyrton bazueshmërinë kushtetuese të të gjitha ligjeve që miratohen në kuvend;
- Shqyrton metodologjin e teknikën e hartimit të legjislacionit në Kuvend;
- Ka segment të caktuar të kompetencave në lëmin e gjyqësisë, në Kosovë;
- Mbikqyrë zbatimin e ligjeve;
- Angazhon ekspertë për çështje të caktuara nga fushveprimi i Komisionit;
- Organizon dëgjime publike në fushat e caktuara të legjislacionit;
- Ushtron veprimtari, sipas autorizimeve të Kuvendit dhe autorizimeve kushtetuese ligjore.



## Plani i Punës 2009

Në bazë të Strategjisë Legjislative të Qeverisë, në fillim të vitit 2009, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka miratuar Planin e Punës në bazë të të cilit është duke i zhvilluar aktivitetet e tij.

Plani i Punës për gjashtëmuajorin e parë ka paraparë që Komisioni: të angazhohet në ndërtimin e infrastrukturës ligjore nën juridiksionin e tij, të grumbulloj informata përmes dëgjimeve publike dhe formave tjera të bashkëpunimit me qëllim të hartimit sa më të mirë të projektligjeve, të formojë nën grupe punuese sipas nevojës, të monitorojë implementimin e zbatimit të së paku një ligji, të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e Kosovës dhe organizatat relevante ndërkombëtare, të punojë në ngritjen e cilësisë së punës dhe bashkëpunimit intern duke përfshirë edhe stafin mbështetës dhe të përmirësojë vizibilitetin e Komisionit dhe komunikimin me qytetarë.



### Mbledhjet e Komisionit

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2009, ka mbajtur gjithsej *28 mbledhje të rregullta*. Gjatë këtyre takimeve, Komisioni ka shqyrtuar Projektligjet që kanë qenë në procedurë, gjatë këtyre

Mbledhjeve ka marrë vendime, propozime, mendime dhe rekomandime konform përmbajtjes së akteve. Për të gjitha projektligjet Komisioni ka përgatitur raporte me amendamente, të cilat i janë rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Për të qenë sa më efektiv, Komisioni ka formuar *8 grupe punuese* për secilin Projektligj, të cilat kanë përgatitur amendamente për komisionin.

Takimet e Komisionit kanë qenë të hapura dhe janë përcjellur nga monitorues vendor dhe ndërkombëtar si dhe mediat. Në mbledhjet e Komisionit janë zhvilluar debate dhe diskutime brenda standardeve demokratike.





## Shqyrtimi i projektligjeve

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, ka shqyrtuar gjithsejt *18 Ligje për bazë ligjore si dhe 8 projektligje si komision funksional*. Ato janë:

### ***Të përfunduara:***

- Projektligji për Avokim;
- Projektligji për të drejtën sendore;
- Projektligji për themelimin e departamentit të mjekësisë ligjore;
- Projektligji për menagjimin e pasurisë së sekuestruar ose konfiskuar;

### ***Në procedurë:***

- Projektligji për konfliktin e interesit;
- Projektligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë;
- Projektligji për hetim parlamentar;
- Projektligji për antikorrupsion;



Gjatë shqyrtimit të këtyre projektligjeve, Komisioni ka ftuar sponsoruesit e këtyre projektligjeve (përfaqësuesitë e Qeverisë) dhe ka pranuar ekspertizë të kanë ofruar organizatat e ndryshme ndërkombëtare.

## **Dëgjimet Publike**

Në gjashtëmujorin e parë, Komisioni, ka mbajtur një dëgjim publik për Projektligjin për hetim parlamentar. Në këtë dëgjim kanë marrë pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues nga KMLDNJ dhe ekspertë të fushës përkatëse.



## Monitorimi i zbatimit të ligjeve

Duke u bazuar në nenin 53 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni ka autoritet të mbikëqyr zbatimin e ligjeve nga Qeveria e Kosovës ose nga Ministria përkatëse. Qëllim i mbikëqyrjes është verifikimi i zbatueshmërisë së ligjeve, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme në fushën që e mbulon ligji.

Në bazë të këtij autoriteti, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në gjashtëmuajorin e parë të 2009- tës ka monitoruar zbatimin e *Ligjit penal për të mitur*. Në kuadër të monitorimit të këtij ligji, Komisioni ka



zhvilluar takime me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimin korrektues, Qendra edukative Lipjan, Gjykata e Qarkut Prishtinë, Gjykata Komunale Prizeren . Si dhe kanë vizituar shërbimin Sprovues rajonal të Prishtinës.

Pas përmbylljes së vizitave në terren dhe grumbullimit të të dhënave të nevojshme, në muajin Qershor 2009, Komisioni ka hartuar raportin me rekomandime, të cilin e ka miratuar dhe i ka rekomanduar Kryesisë së Kuvendit që ta vendos në rend dite për një të radhës për shqyrtim.



### **Statistika**

- Mbledhje të komisionit	28
- Projektligje të shqyrtuara	26
- Grupe punuese të formuara	8
- Mbikëqyrje e ligjeve	1
- Vizita në terren	4
- Dëgjime publike	1

## Përbërja e Komisionit



Bahri Hyseni (PDK)  
Kryetar i Komisionit



Adem Salihu (LDD)  
Zëvendëskryetar i Parë



Branislav Grbić (SLS)  
Zëvendëskryetar i Dytë



Ramadan Gashi (PDK)  
Anëtar



Selvije Halimi (PDK)  
Anëtare



Kolë Berisha (LDK)  
Anëtar



Armend Zemaj (LDK)  
Anëtar



Ibrahim Makolli (AKR)  
Anëtar



Bajram Kosumi (AAK)  
Anëtar



Adem Hajdaraj (LDK)  
Anëtar



Hezair Murati ( )  
Anëtar





## Kontaktet

### *Marrëdhëniet me Publikun*

Sherif Konjufca                      Shef i Seksionit

*Zyra N - 08, Kati përdhes*

038 211 186

[sherif.konjufca@assembly-kosova.org](mailto:sherif.konjufca@assembly-kosova.org)

### *Stafi mbështetës i Komisionit*

Idriz Tahiri                      Administrator i Zyrës

038 211 306

[idriz.tahiri@assembly-kosova.org](mailto:idriz.tahiri@assembly-kosova.org)

Fehmi Hyseni                      Zyrtar i Lartë Ligjor

038 213 807

[fehmi.hyseni@assembly-kosova.org](mailto:fehmi.hyseni@assembly-kosova.org)

Sulltane Gashi                      Nëpunëse Administrative

038 213 786

[sulltane.gashi@assembly-kosova.org](mailto:sulltane.gashi@assembly-kosova.org)

### *Zyrtari mbështetës i Komisionit - NDI*

*Zyra N - 409, Kati IV*

Reshit Gashi                      Zyrtar Legjislativ

038 212 532

[regashi@gmail.com](mailto:regashi@gmail.com)

044 124 415

### *Webfaqja i Kuvendit*

[www.kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org)

### Përkrahur nga:

